



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 107/03-4448 /24

Kaçanik, 15.02.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi civil, z.Fadil Guri, Shef i zyrës për komunitete dhe kthim, caktohet Zyrtar për monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit
2. Zyrtari në fjalë do të shërbej si pikë kontaktuese, për të mbledhur dhe analizuar të dhënat lidhur me lëvizjen e qytetarëve të Komunës, në shtetet e Zonës Schengen.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Ministria e administrimit të Pushtetit Lokal, mbëshettur në Planin e Punës për Menaxhimin e Procesit të Liberalizimit të Vizave me BE-në, ka sjellë Vendimin Nr.22/178, të dates 13.12.2023, për themelimin e Mekanizmit për paralajmërimin e hershëm për monitorimin e trendit të migrimit. Me qëllim që të mbledhjes së të dhënave të mjaftueshme sa i përket kësaj çështje nga Komunitat, ka kërkuar që të caktohet një zyrtar për të monitoruar trendin e lëvizjes të migrimit pas hyrjes në fuqi të udhëtimit pa viza.

Andaj, duke pasur parasysh këto që i theksuam më lartë, përgatitjen profesionale të punëtorit dhe përvojën e punës, u konstatua se zyrtari në fjalë krahas kryerjes së detyrave në vendin e tij të punës të caktohet edhe zyrtar për monitorimin e trendit të lëvizjes së migrimit.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen;

-z. Fadil Guri z.

-Udhëheqësi i personelit dhe



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi